

KËRKESË
Nr.7222, datë 10.12.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i “Kalatës së Limjonit Sarandë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është sh.a.porti Sarandë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 7 321 870 (shtatë milionë e treqind e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë.

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË KALATËS SË LIMJONIT SARANDË

NR.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	ZONA KADASTRALE	NR.PASURISË	NDËRTESE SIP M ²	ÇMIMI LEKË/M ²	VLERA LEKË/M ²	TRUALL M ²	ÇMIMI LEKË/M ²	VLERA LEKË	VLERA TOTALE LEKË
1.	NIKO	SPIRO	LLOJA	8641	1	100					4 533 550	4 533 550
2.	NIKO	SPIRO	LLOJA	8641	1				160	17.427	2 788 320	2 788 320
SHUMA	NIKO	SPIRO	LLOJA									7 321 870